



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 333/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Laziç dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Alternativa Demokratike e Kosovës (ADK) dega në Prizren, për shkak të vendosjes së posterave, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Prizren kështu që subjektit politik Alternativa Demokratike e Kosovës (ADK), dega në Prizren i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 800 (tetëqind) euro të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 23.10.2013, subjekti politik LDK, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, me datë 12.10.2013, në ora 11:00 ADK-ja përkatësisht kandidati për kryetar nga radhët e kësaj partie z. Fadil Sopa në kundërshtim me nenin 3 paragrafi 3.1 të rregullores nr.01/2012 për kategorizimin e sanksioneve dhe gjobave, ka vendosur poster të tij si kandidat për Prizrenin me embleme të ADK-së, mbi posterët e LDK-së dhe mbi kandidatin tonë për Prizrenin z. Eqrem Kryeziu . Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës ka ofruar dy fotografi .

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik ADK, me datën 24.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 25.10.2013 deri në ora 12:00.

PZAP-i, nuk e pranoi përgjigjen në ankesë sipas afatit të caktuar .

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se si posterat e subjektit politik ADK janë vendosur mbi posterat e subjektit politik LDK, gjë që e bënë përgjegjës subjektin politik ADK, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me dispozitën e nenit 33 pika a) të LZP-së të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. që ndalon mbulimin e posterave nga një subjekt tjetër politik.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, konstatoi se subjekti politik ADK ka rënë në kundërshtim me nenin 33 pika a të LZP-së, ngase i ka vendosur posterin e tyre mbi posterin e subjektit politik LDK, shkelje për të cilën është i paraparë dënimi me gjobë andaj në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 333/2013 më datën 25.10.2013



Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi

Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*